

SPECIFIKIME

TEKNIKE

SPECIFIKIMI I TEKNIKE

OBJEKTI: RIKOSTRUKSION OBJEKTE NDERTIMORE 2025

PUNIME TE NDRYSHME NE PRISHJE

Puna për prishje do të fillojë vetëm pasi të jenë stakuar energjia elektrike dhe rrjete të tjera të instalimeve ekzistuese të objektit.

Metodat e prishjes së pjesëshme, duhet të jenë të tilla që pjesa e strukturës që ka mbetur të sigurojë qëndrueshmërinë e ndërtesës dhe të pjesëve që mbeten.

Kur prishja e ndërtesës ose e elementeve të saj nuk mund të bëhet pa probleme e ndarë nga pjesa e strukturës do të përdoret një metodë pune e përshtatshme. Elementë çeliku dhe struktura betoni të forcuar do të ulen në tokë ose do të prihen për së gjati sipas gjerësisë dhe përmasave në mënyrë që të mos bien. Elementët e drurit mund të hidhen nga lart, vetëm kur ato nuk paraqesin rrezik për pjesën tjetër të stukturës. Kur prishen elementët, duhen marrë masa për të mos rrezikuar elementët e tjerë konstruktive mbajtës, si dhe mos dëmtohen elementët e tjerë.

Në përgjithësi, puna e prishjes duhet të fillojë duke hequr sa më shumë ngarkesa të panevojshme, pa ndërhyrë në elementët bazë struktural. Punë të kujdesshme do të bëhen për të hequr ngarkesat kryesore nën kushtet më të vështira.

Siguria në punë

Kontraktori duhet të sigurohet se vendi dhe pajisjet janë :

- a) Të një tipi dhe standarti të përshtatshëm duke iu referuar vendit dhe llojit të punës që do të kryhet
- b) Të siguruar nga një teknik kompetent dhe me ekperience

c) Të ruajtura në kushte të mira pune gjatë përdorimit

Gjatë punës prishëse të gjithë punëtorët duhet të vishen me veshje të përshtatshme mbrojtëse ose mjete mbrojtëse si: helmata, syze, mbrojtëse, mbrojtëse veshësh dhe bombola frymëmarrjeje.

Prishja e çatisë

Shpërbërja e mbulesës së çatisë me tjegulla dhe të armaturës përkatëse prej druri, duke përfshirë trarët e mundshëm, dyshemenë ose paretet (ndërmjetëzat) me dërrasa, armaturën e madhe (e përbërë nga kapriatat, Trarët dhe pjesët e armaturës), pjesët intersektuese, kanalet e ulluqëve horizontale, ulluqët vertikale dhe kapset përkatëse metalike që rezultojnë nga heqja brenda ambientit të kantierit, si dhe zgjedhjen, pastrimin si dhe çdo detyrim tjetër për t'i dhënë fund heqjes.

Prishja e mureve të tullës

Prishje e muraturës me tulla të plota ose me vrima, e çfarëdo lloji dhe dimensionit, edhe e suvatuar ose e veshur me majolikë, që realizohet me çfarëdo lloji mjeti dhe e çfarëdo lartësie ose thellësie, përfshirë skelën e shërbimit ose skelerinë, armaturat e mundshme për të mbështetur ose mbrojtur strukturat ose ndërtesat përreth, riparimi për dëmet e shkaktuara ndaj të tretëve për ndërprerjet dhe restaurimin normal të tubacioneve publike dhe private (kanalet e ujrave të zeza, ujini, dritat etj.), si dhe vënien mënjane dhe pastrimin e gurëve për përdorim, duke bërë sistemimin brenda ambientit të kantierit. Gjithashtu, edhe çdo detyrim tjetër që siguron plotësisht prishjen.

PUNIME MURATURE TULLE

Ne kete cmim parashikohet teresia e shpenzimeve qe nevojiten per realizimin e 1 m3 mur tulle llaç I perzier. M=15 per ndertimin e parapeteve te demtuara, oxhaqeve sipas detajit teknik me gjeresi dhe lartesi sipas projektit . Ne cmim futet teresia e shpenzimeve per blerjen e materialeve rere guri, cemento,tullat, transportin. Llaci te prodhohet me betoniere ne objekt sipas kushteve teknike dhe standartet, me rere guri, te realizohet marka e kerkuare llacit.

NDERTIMI I ÇATISE

Ndertimi i çatise e matur horizontalisht do te realizohet me lende druri te sharuar e mbeshtetur mbi trare te sharuar dhe te stazhionuar.

Lenda e drurit do te jete e stazhionuar ne menyre natyrale ose artificiale , inprejuar me vaj te djegur te pershtatshem per lenden e drurit .

Makazet e catise do te jene 5x3 ne cdo 33 cm

Permasat e mahive 10x6 cm largesia e tyre cdo 60 cm

Tjegullat do te jene te reja betonike importi cilesi e pare, te gozhduara ose te lidhura duke perfshire lidhjen e ulluqeve horizontale te catise dhe kulmeve duke perdorur llac bastard M-25 tel xingato , skelari ose cdo ndryshim tjeter te nevojshem per ta perfunduar punen.

Ne drejtim gjatesor do te vendosen kontroventime me permasa 10x6 cm.

Dalje në çati

Daljet në çati duhet të planifikohen për këto raste:

- Dalje për pastrimin e oxhakëve
- Dalje për heqjen e borës në raste se ajo e rëndon për së tepërmi çatinë dhe e rrezikon mbajtshmërinë e saj.
- Dalje për të bërë ndonjë riparim në çati.

Për objekte me çati duhet paraparë / planifikuar një dalje e sigurtë prej nënçatisë. Kjo dalje duhet të realizohet me anë të një dritareje me përmasa 60 cm x 80 cm, e cila duhet të lidhet mirë me mbulesën e çatisë në mënyrë që të mos kemi rrjedhje të ujit.

Dalja në taracë ose në nënçati duhet të ketë dimensionin: max. 80 x 120 cm.

Me rëndësi është që kapaku i daljes në çati t'i plotësojë kërkesat e mbrojtjes kundër zjarrit si dhe kërkesat e koeficientit të ruajtjes të ngrohjes të tij

ULLUKE HORIZONTALE

Realizohen me pjeresi prej 1% per largimin e ujrave .Ulluqet horizontale prolohen me llamarine xingato me trashesi jo me te vogel se 0.8 mm, i formuar nga pjese te modeluara me mbivendosje minimale 5cm , te salduara ne menyre te rregullt me kallaj , me bord te jashtem 2 cm me te ulet se bordi i brendeshem te kompletuara me pjese speciale ne gryken e hyrjes . Ulluku horizontal i modeluar sipas udhezimeve ne projekt , duhet te jete i lidhur me tel xingato me hallka te forta te vena maksimumi ne 70 cm .

ULLUKE VERTIKALE

Ulluket vertikale per shkarkimin e ujrave te catise dhe te taraces se banjes te pergatiten me llamarine prej celiku te xinguara , duhet te kene trashesi jo me te vogel se 0.6 mm dhe diameter 10 cm , kurse ulluket horizontale prej xingato kane diameter nga 8deri 12 cm dhe mbulojne nje siperfaqe nga 30_60 m2. Ne cdo ulluk duhet te mblidhen ujrart e nje siperfaqe catie ose tarrace jo me te madhe se 60 m2. Ulluket duhet te vendosen ne pjesene jashtme te nderteses me ane te qaforeve perkatese prej celiku te xinguara , te fiksuar cdo 2 m .Pjesa fundore e ulluqeve , per lartesine 2 m duhet te jete PVC dhe e mberthyer fort me ganxha hekuri si dhe poshte duhet te kthehen 90 grade.

BETON C – 16 /20

Ne kete cmim parashikohet teresia e shpenzimeve qe nevojiten per realizimin e 1 m3 beton C – 16 / 20 per ndertim brez betoni ,betonin rreth objekteve duke respektuar projektin, ne cmim futet dhe teresia e shpenzimeve per prodhimin ose blerjen e materialeve inerte , cemento, transportin ,pergatitjen e betonit dhe hedhjen ne veper , ngjeshjen me vibrator , dhe trajtimin me uje per realizimin e markes te kerkuar dhe dizarmimin e armatures . Ne cmim futet dhe testet e bera per marken e betonit. Betoni te merret I gatshem nga nje nyje e mekanizuar ose te prodhohet me betoniere ne objekt sipas kushteve teknike dhe standartet, me rere guri + cakell, te realizohet marka e kerkuar e betonit. Ne cmim futet dhe testet e bera per marken e betonit.

SUVATIM FASADE

Sprucim i mureve dhe strehve, me llaç çimentoje të lëngët për përmirësimin e ngjitjes së suvasë dhe rificimin e sipërfaqeve të muraturës, duke përfshirë skelat e shërbimit dhe çdo detyrim tjetër për ta përfunduar plotësisht sprucimin.

Suvatim i realizuar nga një shtresë me trashësi 2 cm llaçi bastard m-25 me dozim për m²: rërë e larë 0,005 m³; llaç bastard 0.03 m³; çimento 400, 7.7 kg; ujë, i aplikuar me paravendosje të drejtuesve në mure (shirtit me llaç me trashësi 15 cm çdo 1 deri në 1,5 m), dhe e lëmuar me mistri e bërda, duke përfshirë skelat e shërbimit si dhe çdo detyrim tjetër për ta përfunduar plotësisht suvatimin.

VESHJE FASADE ME POLISTEROL KOMPAKT JESHIL t=5 cm +RJETE +SUVA

Veshja e fasades do te realizohet me polisterol kompakt 18kg/m³ me trashesi t=5 cm. Ne çmim futet polisteroli ,rrjeta dhe suvaja grafiato , skelat e sherbimit dhe cdo detyrim tjetet per ti dhene plotesisht fund veshjes se fasades .Suvatimi i realizuar nga nje shtrese me trashesi 2 cm llaci bastard m_25 dozim per m2 rere e lare m3 0.005 m3, llac bastard m3 0.03 , cimento 400 7.7kg , uje e aplikuar ne baze te udhezimeve te pergatitura ne mure dhe e lemuar me mistri e berdaf, duke perfshire skelat e sherbimit dhe cdo sherbim tjetet .Polisteroli te shoqerohet me certifikaten e cilesise.

LYERJE ME BOJE PLASTIKE

Përpara fillimit të punimeve, kontraktori duhet t'i paraqesë për aprovim Supervizorit, markën, cilësinë dhe katalogun e nuancave të ngjyrave të bojës, që ai mendon të përdorë. Të gjitha bojrat që do të përdoren duhet të zgjidhen nga një prodhues që ka eksperiencë në këtë fushë. Nuk lejohet përzjerja e dy llojevë të ndryshme markash boje gjatë procesit të punës. Hollimi i bojës duhet të bëhet vetëm sipas udhëzimeve të prodhuesit dhe aprovimit të Supervizorit. Gjithashtu, duhet të pastrohen kur mbaron lyerja në çdo ditë. Personeli që do të kryejë lyerjen, duhet të jetë me eksperiencë në këtë fushë dhe duhet të zbatojë të gjitha kushtet teknike të lyerjes sipas KTZ